



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") në mbledhjen së vet të datës 17.05.2017 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 02/2017

RREGULLORE E PROTOKOLIT TË KOMUNIKIMIT TË FAK

Me këtë rregullore definohet hierarkia dhe menyrat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të FAK.

Neni 1.

Mjetet dhe adresat e komunikimit zyrtar të FAK-ut

1.1 Bordi i FAK si organi më i lartë ekzekutiv i Federatës Aeronautike të Kosovës është i qasshëm përmes këtyre mjeteve dhe adresave për komunikim:

- **Adresa fizike e FAK:**
Rr. Agim Ramadani, pallati i federatave (ish Sllovenia sporti), 10000 Prishtinë, Kosovë
- **Adresa elektronike e FAK:**
info@aeronautika.org
- **Bordi i FAK:**
kryesia@aeronautika.org
- **Presidenti i FAK:**
presidenti@aeronautika.org dhe emaili privat i presidentit i cili është i listuar në webfaqe
- **Sekretari i FAK:**
sekretari@aeronautika.org



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 2.

Komunikimi i FAK me partnerët dhe institucionet e ndryshme

2.1. Me qëllim të rritjes së transparencës së komunikimeve dhe me qëllim të ndarjes së përgjegjësisë në mes të anëtarëve të bordit, bordi i FAK është i obliguar të nxjerrë vendim se cilët nga anëtarët e bordit janë të ngakuar me komunikim me cilët partner dhe cilët institucione. Bordi është i obliguar të përcaktoj këtë komunikim të paktën me këto partnerë dhe institucione:

- Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
- Forcat e sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës
- KFOR J3
- Mediat (të gjitha format e prezantimit)
- Bizneset e ndryshme me qëllim të sponsorizimit të FAK

Për shkak të rëndësisë së veçantë, të nevojës për komunikim më të shpeshtë dhe/ose për përshtatje me mënyrën e tyre të komunikimit, për komunikim me institucionet e më poshtme përcaktohen Kryetari i FAK dhe/ose Sekretari i FAK:

- Ministria për kulturë rini dhe sport e Republikës së Kosovës
- Federata Ndërkombëtare Aeronautike - FAI
- Komiteti Olimpik i Kosovës

Neni 3.

Komunikimi brenda bordit të FAK

3.1. Anëtarët e bordit të FAK për komunikim zyrtar me bordin e FAK janë të obliguar të përdorin adresën elektronike kryesia@aeronautika.org, të gjitha kërkesat, ankesat, komentet, sygjerimet ose shkresat tjera adresohen në këtë adresë elektronike. Në rastet kur është e pamundshme përdorimi i adresave elektronike dhe për ndonjë urgjencë është e pranueshme edhe përgjigjja me shkrim në grupin e kryesisë të Facebook-ut. Sidoqoftë kjo mënyrë nuk duhet të mbetet si praktikë e shpeshtë.

Neni 4.

Komunikimi i bordit FAK me komisionet e FAK

4.1. Çdo komision i krijuar nga bordi i FAK-ut ka të përcaktuar edhe kryetarin e komisionit. I gjithë komunikimi në mes të bordit të FAK dhe komisionit përkatës zhvillohet përmes kryetarit të komisionit.



Federata Aeronautike e Kosovës

4.2 Është përgjegjësi e kryetarit të komisionit përkatës të sjellë kërkesat, ankesat, komentet dhe sygjërimet e ndryshme të komisionit përkatës në bordin e FAK.

4.3 Është përgjegjësi e kryetarit të komisionit përkatës t'i mbajë të informuar anëtarët tjerë të komisionit për vendimet e bordit dhe për përgjigjet/kërkesat/sygjerimet eventuale të marra nga bordi për kërkesat e ndryshme të komisionit.

4.4 Është përgjegjësi e kryetarit të komisionit përkatës të mbajë komunikim me anëtarët e komisionit përkatës në cilat do forma që anëtarëve iu përshtatet.

Neni 5.

Komunikimi me klubet anëtare të FAK dhe pilotët

5.1. Çdo klub anëtar i FAK-ut ka të përcaktuar personin përgjegjës për komunikim zyrtar në mes të Klubit përkatës dhe Federatës Aeronautike të Kosovës. I gjithë komunikimi në mes të FAK dhe Klubit anëtarë zhvillohet përmes personit të përcaktuar nga klubi në njërin anë dhe nga kryetari i FAK dhe/ose Sekretari i FAK në anën tjetër.

5.2 Është përgjegjësi e personit të përcaktuar nga klubi për komunikim zyrtar me FAK të sjellë kërkesat, ankesat, komentet dhe sygjërimet e ndryshme të klubit përkatës në FAK. Sipas vlerësimit dhe kompetencave të kryetarit/sekretarit të FAK këto shkresa pastaj mund të adresohen në bordin e FAK sipas mënyrës së rregullt të komunikimit brenda bordit.

5.3 Është përgjegjësi e personit të përcaktuar nga klubi për komunikim zyrtar me FAK të mbajë të informuar kryesinë e klubit dhe anëtarët tjerë të klubit për vendimet e FAK dhe për përgjigjet/kërkesat/sygjerimet eventuale të marra nga FAK. Për çfarëdo problemi apo moslajmërimi me kohë nga zyrtari i klubit tek personat tjerë në klub, federata nuk mbanë asnjë përgjegjësi.

5.4 Federata Aeronautike e Kosovës nuk mban komunikime të drejtëpërdrejta zyrtare me pilotët anëtarë të klubeve. Të gjitha kërkesat, ankesat, komentet, sygjërimet, përgjigjet, vendimet dhe shkresat tjera që ndëlidhen me ndonjë pilotë, FAK është i obliguar t'i drejtoj tek personi përgjegjës për komunikim zyrtar në mes të Klubit të cilës i takon piloti dhe FAK.

5.5 Pilotët të cilët kanë ndonjë kërkesë, ankesë, koment, sygjërim etj ndaj FAK, ato i adresojnë tek kryetari/sekretari i FAK përmes personit të përcaktuar nga klubi të cilës i përkasin për komunikim zyrtar mes klubit dhe FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 6. Hyrja në fuqi

7.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 17.05.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK